



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

Nr.5365Prot

Krujë, më 25.06. 2026

**NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE**  
**NË INSPEKTORIATIN E MBROJTJES SË TERRITORIT”**  
**BASHKIA KRUIJË**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 64, germa g; ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” I ndryshuar, ligjit Nr. 9780 datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, I ndryshuar”, Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr .190 datë 04.05.2026” Për miratimin e ndryhsimeve në strukturën organizative të Bashkisë Krujë ;

**Bashkia Krujë shpall vendet e lira të punës :**

- **1 (një) Kryeinspektor në Sektorin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit**
- **1 (një) Inspektor në Sektorin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit 1**

Afati i fundit i paraqitjes së aplikimeve është data 06.07.2026

➤ **Detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të “Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së territorit” janë:**

1. Organizon dhe drejton punën në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë dhe përgjigjet para Kryetarit të Bashkisë.
2. Harton plane afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata mbi veprimtarinë e Inspektoratit.
3. Siguron zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore gjate punes,
4. Ushtron përgjegjësitë për dhënien e masave disiplinore në rast të konstatimit të shkeljeve administrative nga inspektorët.
5. Ushtron përgjegjesite e tij kur konstaton shkelje te ligjshmerise ne fushen e ndertimit.
6. Merr masat e parashikuara ne ligj kur konstaton shkelje ligjore.
7. Bashkëpunon dhe koordinon punën me Drejtorinë e Planifikimit të Kontrollit edhe Zhvillimit të Territorit duke marrë informacion mbi kërkesat për leje zhvillimi dhe përdorimi në territorin e bashkisë.
8. Pasqyron veprimet që kryen gjate ushtrimit te kompetencave ligjore në aktet administrative sipas standarteve ligjore të miratuara .



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

9. Nxjerr vendime për dhënien e masave administrative në ngarkim të subjekteve që shkelin ligjshmërinë në fushën e ndërtimit, siç parashikohet në aktet ligjore në fuqi.
10. Siguron bashkëpunimin dhe koordinimin e punëve me njësitë strukturore të tjera të bashkisë.
11. Respekton afatet ligjore gjatë kryerjes së procedurave.
12. Në zbatim të detyrimeve ligjore, kërkon zyrtarisht mbështetjen e strukturave të Policisë së Shtetit dhe të Policisë Bashkiake.
13. Shpërndan korrespondencën dhe ndjek trajtimin e saj nga vartësit.
14. Për realizimin e funksionit të tij, me miratimin e Kryetarit të Bashkisë, nxjerr rregullore të brendshme të funksionimit të Inspektoratit, urdhra dhe vendime.
15. Përfaqëson Bashkinë Krujë në raport me institucionet e tjera shtetërore, me autorizim të Kryetarit të Bashkisë Krujë, për problemet që mbulon ligjërisht Inspektorati.
16. Raporton tek eprori direkt për kryerjen e detyrave.

➤ **Detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të “Inspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së territorit” janë:**

1. Ushtron funksionet ligjore Brenda kufijve territoriale të Bashkisë
2. Ushtron kontroll në gjithë territorin e Bashkisë , vecanerisht në subjektet e ndërtimit, sipas planit të miratuar më parë nga kryeinspektori,
3. Merr pjesë në ekzekutimin e të gjithë vendimeve për prishje të objekteve të paligjshme Brenda territorit të Bashkisë.
4. Pasqyron veprimtarinë e punës në procesverbalin e ekzekutimit të cilin ja dorëzon kryeinspektorit.
5. Vlerëson konfliktet sociale gjatë ndërtimit , ankesa këto të ardhura me shkrim nga subjekte të ndryshme dhe jep mendime për menyrën e zgjidhjes ligjore.
6. Ndjek dhe zbaton urdhrat dhe detyrat e dhëna nga kryeinspektori gjatë ushtrimit të kontrolleve .
7. Arkivon dokumentacionin e administruar gjatë ndërhyrjes për prishje objektesh të paligjshme si :1)Procesverbal konstatimi 2) Vendim për prishjen e objektit3) Njoftim të kundërvajtësit për zbatimin vullnetar të urdhrit,4) Procesverbal të ekzekutimit ose jo të urdhrit.
8. Kryen edhe cdo detyrë tjetër të caktuar nga eprori direkt.

➤ **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e posaçme si vijon:**

- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. të jetë në kushte shëndetësore që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

- d. të ketë përfunduar arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.”
- e. të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundravajtje penale;
- f. ndaj tij /saj të mos jetë marë masë disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- g. të ketë eksperimentuar punë;
- h. të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;
- i. Të ketë njohuri për Kodin e Procedurave Administrative; Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin Nr. 9780 datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, I ndryshuar”, Ligjin nr. 107/2014 ” Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vkm Nr 894 datë 04.11.2015”Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar I Mbrojtjes se Territorit dhe ai i Njesisë Vendore.

➤ **Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore dokumentacionin e mëposhtëm për aplikim dhe pranim:**

- a. Kërkesë ;
- b. Jetëshkrimin;
- c. Fotokopje e kartës së identitetit;
  - a- Fotokopjet e noterizuara të diplomës; (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njesimi nga Ministria Arsimit dhe Sportit.
- d. Foto – 2(dy) copë me përmasa 4 \* 6 cm;
- e. Raportin mjekoligjor mbi gjendjen shëndetsore;
- f. Çertifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti);
- g. Vërtetim gjykate dhe prokurorie;
- h. Librezë pune ( në qoftë se ka punuar);
- i. Vlerësimin e fundit të punës ,kur aplikantët vijnë nga administrate publike;
- j. Vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose pranë Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Krujë ,**brenda datës 06.07.2026.**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KRUIJË**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

**REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT**

Brenda datës 08.07.2026 Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Krujës do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e vecanta të procedurës së punësimit do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në mënyrë elektronike, për shkaqet e skualifikimit ( nëpërmjet adresës së email).

**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Krujës do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Bashkisë. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Burimeve Njerëzore për rezultatet(nëpërmjet adresës e-mail-it).

**KRYETARI I BASHKISË**

**ARTUR BUSHI**